

ALLAH URDHËRON DREJTËSI DHE TË BËSH MIRË

Islami është feja e paqes. Një shoqëri në të cilën vlerat e vërteta morale Islamike respektohen, është një shoqëri që e karakterizon paqja, falja, dashuria, mëshira, kënaqësia dhe mbështetja në heshtje.

Për këtë arsye, terror do të thotë të ushtrosh dhunë njerëzve të pafajshëm, gjë që është një akt që nuk lë ndonjë justifikim moral. Kjo gjë është sikurse krimi i vrasjeve të bëra nga Hitleri apo Stalini, ështrë një krim i kryer kundrejt mbarë njerëzimit.

Kur'ani është një libër i shpallur njerëzve si një udhëzim i rrugës së vërtetë dhe në këtë libër ALLAHU urdhëron njerëzit të adaptojnë vlerat e mira morale. Ky moral është bazuar nën koncepte të tilla si dashuria, mëshira, toleranca dhe falja, kompasioni. Fjala "Islam" është derivat i fjalës "paqe" në Arabisht. Islami është një fe e shpallur njerëzimit me qëllim të një jetese të paqte me anë të cilës mëshira dhe falja, kompasioni i Allahut manifestohet në tokë. Allahu i thërret të gjithë njerëzit drejt vlerave morale Islamike përmes të cilave falja, kompasioni, mëshira, paqja dhe toleranca mund të ushtrohen në mbarë botën.

Në Suren Bakara, ajeti 208, Allahu i adresohet besimtarëve si më poshtë vijon:

2:208. O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishëm (përqafojeni fenë islame në tërësi), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik juaji i hapët.

Ashtu sikurse ajeti qartëson, siguria mund të sigurohet vetëm "duke hyrë në islam" do thënë të jetosh sipas vlerave të Kur'anit. Vlerat e Kur'anit e bëjnë Muslimanin të përgjegjshëm për të trajtuar të gjithë njerëzit Muslimanë dhe jo -Muslimanë njerëzisht dhe drejtësisht, të mbrojnë nevojtarët dhe pafajshmit dhe "të ndalojnë përhapjen e ligësive." Ligësia sjell të gjitha format e anarshisë dhe të terrorit dhe zhvendos sigurinë, rehatinë dhe paqen. Sikurse ALLAHU thotë në një ajet Kur'anor, "E All-llahu nuk e do çrregullimin (fesadin)." (Kur'an, Sura Bakara, 2:205)

Vrasja e një njeriu pa arsye është një nga shembujt më të dukshëm të ligësisë. Allahu përsërit në KURAN një urdher të cilin AI më parë ia pat shpallur dhe Çifutëve në Testamentin e Vjetër kështu:

Sura Maide. 5:32. Për këtë (shkak të atij krimi) Ne u shpallëm (ligj) beni israilëve se kush mbytet një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit. Atyre (beni israilëve) u erdhën të dërguarit Tanë me argumente, mandej edhe pas këtij (vendimi) shumë prej tyre e teprojnë (kalojnë kufijtë në mbytje) në këtë tokë.

Sikurse ajeti sugjeron, një person i cili vret qoftë dhe një njeri të vetëm, "nëqofëse është një hakmarrje për dikë tjetër ose për të përhapur korrupsion në botë" ai kryen një krim sikurse të kishte vrarë mbarë njerëzimin.



<https://www.harunyahya.info/sq/artikujt/allah-urdhEron-drejtEsi-dhe-tE-bEsh-mirE>